

DEKRET
Nr. 471, datë 12.12.2025

PËR EMËRIMIN E GJYQTARIT TË GJYKATËS SË LARTË

Në mbështetje të nenit 93, nenit 136, pikat 1 dhe 2, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe të nenit 48, pika 13, të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar; bazuar në vendimin nr. 818, datë 4.12.2025, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, “Për propozimin për emërim në Gjykatën e Lartë të kandidatit z. Genti Shala”, për pozicionin e lirë në fushën e së drejtës penale, shpallur me vendimin nr. 178, datë 11.5.2022, të Këshillit të Lartë Gjyqësor,

DEKRETOJ:

Neni 1

Zoti Genti Shala emërohet gjyqtar i Gjykatës së Lartë nga radhët e gjyqtarëve.

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENT I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj